



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT**

RELACION

PROJEKT-ZBATIM

**STUDIM-PROJEKTIM:
NDËRTIMI SHKOLLËS 9-VJEÇARE
“22 TETORI” DHE PARKIM NENTOKESOR**

MARS 2024

PERMBAJTJA

1.	INFORMACION I PERGJITHSHEM	3
1.1.	HYRJE	3
1.2.	OBJEKTIVAT E PROJEKTIT	3
2.	STANDARTET	4
2.1.	STANDARTET NE PROJEKTIM	4
2.2.	STANDARTE PER HARTIMIN E PROJEKTIT	4
3.	PRITSHMERITE	4
4.	SHESHI.....	5
4.1.	POZICIONI I SHESHIT	5
4.2.	PERSHKRIMI I SHESHIT	5
4.3.	VLERESIMI FIZIK I OBJEKTIT.....	5
5.	DORËZIMI I SKICË IDEVE	6
5.1.	KONCEPTI.....	6
5.2.	PROGRAMI	7
5.2.1.	KATI NEN TOKE	7
5.2.2.	KATI PERDHE	7
6.	PALETA E MATERIALEVE	15
7.	BIMESIA	15

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

1.1. HYRJE

Bashkia e Beratit kërkoi që të realizohet hartimi i projekt – zbatimit (studim – projektim) dhe akt – ekspertizën e thelluar për objektin: **Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare “22 Tetori” dhe parkim nentokesor.**

Në këtë territor ku ndodhet shkolla aktuale, do të ndërtohet një objekt i ri arsimor me qëllimin që të plotësojë nevojat për arsimim në këtë zonë, si dhe do të ndikojë në uljen e numrit të nxënësve në klasa në shkollat ekzistuese të cilat ndodhen në kete bashki.

Me lidhjen e kontratës për objektin **“NDËRTIMI I SHKOLLËS 9-VJECARE “22 TETORI” DHE PARKIM NENTOKESOR”** grupi projektues **STUDIO REBUS**, përpara fillimit të përgatitjes së dokumentacionit teknik për projektin në fjalë, ka bërë inspektimin e objektit dhe të zonës ku përfshihet ai, ka analizuar dokumentacionin paraprak lidhur me matjet topografike, dokumentacionin lidhur me gjendjen ekzistuese të strukturës, të rrjeteve inxhinierike (azhornimet përkatëse) si dhe ka analizuar kërkesat e shprehura në detyrën e projektimi referuar konstatimeve në vend.

Per shkak te periudhes kur eshte ndertuar godina dhe meqenese I ka kaluar 50 vite rekomandohet realizimi I **Akt-ekspertizes se thelluar** e cila duhet ti nenshtrohet procesit te oponences teknike nga Insituti i Ndertimit dhe ky i fundit ka dal në konkluzionet perkatese.

Duke patur ne konsiderate gjendjen e amortizuar dhe demtimet e godines, kushtet e papeshtatshme ne te cilat zhvillohet mesimi, mungesen e palestres sipas standarteve, mosperputhshmerine me standartet aktuale ne fuqi te miratuara nga MASH, mungesen e sistemit te ngrohjes qendrore dhe MKZ, bibliotekes, laboratorit te informatikes., ambjenteteve te sherbimit mjekesor, hapësirave administrative si salla per mesuesit, hapësirave shoqërore, u arrit ne konkluzionin qe rehabilitimi I godines ekzistuese eshte joeficent, dhe me kosto me te larte sesa realizimi I ndertimit te ri, si rrjedhoje propozohet ndertimi I godines se re te shkolles “22 Tetori”.

1.2. OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në modernizimin, rritjen e standardeve funksionale dhe kapacitetit maksimal të nxenesve.

Vetë projekti synon të përmirësojë standardet persa i perket procesit të mesimdhënes, sigurisë, të optimizojë dhe të sigurojë një lëvizshmëri dhe aksesueshmëri efektive në përputhje me praktikatat dhe standardet më të mira kombëtare dhe/ose ndërkombëtare.

Shkolla 9-vjeçare “22 Tetori” propozohet për ndërtim të ri në truallin e godinës kryesore. Shkolla e re do të ndërtohet me kapacitet për rreth 600 nxënës, për të plotësuar nevojat e komunitetit të zonës. Ajo do të përmbajë ciklin 9-vjeçar dhe parashkollor.

2. STANDARTET

2.1. STANDARTET NE PROJEKTIM

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standardet për projektimin e ndërtesave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi ku do të përfshihen standardet vendore KTP 78-89, standardet evropiane EN dhe Eurokodi, standardet në fuqi të projektimit të hartuara nga MASH për objektet arsimore (*VKM 319 datë 12.04.2018*). Në rast se për çështje të caktuara nuk mund të zbatohet asnjë nga standardet e mësipërme, projektuesi do t'i referohet standardeve BS. Dizajni duhet të sigurojë përputhjen me standardet, madje duke vendosur standardet e zbatueshme gjatë procesit të zbatimit. Është përgjegjësi e Projektuesit të sigurojë saktësinë dhe respektimin e të gjitha standardeve dhe normave përkatëse. Projektuesi mund të rekomandojë gjithashtu futjen e standardeve të reja për përafrimin me normat e BE-së, si dhe me praktikatat më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim.

2.2. STANDARTE PER HARTIMIN E PROJEKTIT

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, Projektuesi ka përdorur programet e nevojshme kompjuterike, duke përfshirë programe si: Autocad 2020, 3DSMax+ Vray, Paketa Microsoft Office. Projektuesi ka marrë në konsideratë dhe ka përdorur edhe programe të tjera më të reja, në varësi të llojit të punës, më të avancuara të fushës, përfshirë edhe programet BIM në arkitekturë.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit janë patur parasysh dhe janë respektuar të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për planifikimin e territorit”, Rregulloret dhe Legjislacionet në fuqi, si për dokumentimin e projektit të zbatimit edhe për paraqitjen e dokumentacionit për leje ndërtimi.

3. PRITSHMERITE

Kryerja e projektit, funksionet e të cilit plotësojnë standardet në fuqi të projektimit të hartuara nga MASH për objektet arsimore (*VKM 319 datë 12.04.2018*), si dhe ato ndërkombëtare, standardet e ndërtimit duke përfshirë Eurokodin 8.

Projektimi i një shkolle bazuar në përvojat më të mira ndërkombëtare përsa i përket skemave funksionale, teknikave të ndërtimit dhe materialeve që do të përdoren.

Ngritja e një kompleksi modern në aspektin e aplikimit të teknologjive të avancuara në ndërtim, duke përfshirë teknologjitë e gjelbra me një konsideratë të veçantë në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe ruajtjen, reduktimin e konsumit të energjisë dhe prodhimit nëpërmjet burimeve të rinovueshme të energjisë.

Shkolla për arsimin 9- vjeçar duhet të ketë të gjitha ambientet e nevojshme akademike (klasat mësimore, duke përfshirë laboratorët e fizikës, kimisë, biologjisë, informatikës etj.), palestër me ambientet ndihmëse të saj, hapësirat administrative, hapësirat shoqërore, etj. Objekti duhet të ketë të instaluar sistemin e ngrohjes qendrore dhe MKZ. Sistemit të oborrit të shkollës duhet ti kushtohet një rëndësi e veçantë. Ambienti i jashtëm duhet të jetë i sistemuar, duke përfshirë ambientet funksionale përkatëse, terrenet sportive, me gjelbërim dhe me ndriçim të jashtëm.

4. SHESHI

4.1. POZICIONI I SHESHIT

Vendndodhja: Objekti ndodhet Pranë rrugës “Antipatrea”, Berat.

4.2. PERSHKRIMI I SHESHIT

Shkolla 9- vjeçare “22 TETORI” është ndërtuar ne vitin 1965.

Sipërfaqja e përgjithshme e territorit është rreth 2750 m², ku 1700m² është hapësirë e jashtme dhe 1050 m² sipërfaqe e gjurmës së ndërtimit.

Kapaciteti: Në total shkollën e frekuentojnë rreth 650 nxënës. Ambjentet janë të shpërndara në 3 kate në një sipërfaqe ndërtimi total prej 2150 m². Në këto ambiente ndodhen 15 klasamësimore, laborator informatike dhe palestër e mbyllur.

Tipi i strukturës është strukturë me mure mbajtëse.



Figura 1 Vendodhja e shkollës 9–vjeçare “22 Tetori”

4.3. VLERESIMI FIZIK I OBJEKTIT

Pas verifikimit në terren të gjendjes faktike të kësaj shkolle si dhe konstatimit të dëmtimeve të ardhura si pasojë e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, është bërë evidentimi i problematikave të kësaj godine. Nga vlerësimet e kryera rezulton që godina ka pësuar dëmtime të konsiderueshme nga tërmeti. Gjithashtu nga vlersimet rezulton që ato kanë edhe një sërë dobësish nga mënyra dhe materialet e përdorura për ndërtimet e tyre.

Per shkak te periudhes kur eshte ndertuar gonina dhe meqenese I ka kaluar 50 vjet rekomandohet realizimi I Akt-Ekspertizes se thelluar e cila duhet ti nenshtruar procesit te oponences teknike nga Insituti i Ndertimit dhe ky i fundit ka dal në konkluzionet perkatese.

5. DORËZIMI I SKICË IDEVE

5.1. KONCEPTI

Objekti : Shkolla 9 vjecare “22 Tetori” dhe parkim nentokesor Berat ka këtë skemë funksionale.

Parametrat kryesorë janë

Sipërfaqe Parcele 2836.7 m²

Sipërfaqe gjurme 1310.6 m²

Koeficienti I shfrytëzimit të territorit 46 %

Sipërfaqe totale ndërtimi 6361.5 m²

Shkolla e re 22 Tetori parashikohet të zhvillohet në tre kate.

Funksionet pozicionohen linearisht përgjate një aksi qendror i cili shërben si holl për shkollën. Ky aks ka drejtim levizje verilindje-jugperendim kurse funksionet përgjate tij ku janë të përcaktuara klasat laboratorët dhe ambjentet e tjera kanë orjentim veriperendim-juglindje, një orjentim me optimal përsa i përket diellit. Hyrja kryesore ndodhet në jug-lindje të objektit.

Sipërfaqja totale mbi tokë është 4010.45 m².

Gjurma e objektit 1310.6 m² (46%)





Fig.6 Planvendosja

5.2. PROGRAMI

5.2.1.KATI NEN TOKE

Kati nen toke eshte parashikuar te jete parkim i cili ka aksesin kryesor nga rruga ne lindje pasi jane ne te njejte kuote. Parkimi ka nje kapacitet prej 34 makinash dhe ka akses te kontrolluar.



Plani I katit nen toke

5.2.2.KATI PERDHE

Ne kete propozim kemi nje koncept jashte tradicionales, nje godine gjeometria e se ciles eshte derivat i manipulimit te permbajtjes programatike te elementeve perberes te shkollës në një të vetme.

Rezultati eshte nje strukture gjeometrike dhe programatike uniforme dhe unike e cila jo vetem qe shfaqet si nje e tere por edhe siguron fluiditetin e nevojshem per sa i takon komunikimit vizual dhe flukseve te levizjes dhe komunikimit.

Struktura e perftuar natyrshem krijon hyrjen dhe hollin kryesor i cili sherben si zemra e kompleksit duke siguruar menaxhimin e flukseve kryesore te objektit dhe nderveprimin social midis elementeve perberes te shkollës.


Pavaresia relative e elementeve perberes sigurohet nepermjet krijimit te nukleve te pavarura te cilat krijojne nje nivel te konsiderueshem nderveprimi social dhe profesional specifik per shkollën. Nuklet kane nje komunikim fluid me hollin kryesor duke siguruar perceptimin e objektit si nje i tere dhe i pandashem.

Ne katin perdhe jane pozicionuar salla polifunksionale, klasa, biblioteka, dhoma e mjekut, dhome PAK , palestra dhe ambjentet e saj ndihmese, tualetet dhe ambjete te tjera teknike. Gjithashtu ne kete kat eshte vendosur nje klase per PAK dhe nje laborator per muzike dhe pikturën. Gjithashtu ne kete kat jane vendosur edhe salla per shume funksione dhe biblioteka per te patur nje komunikim me te mire dhe te drejtperdrejte me oborret perkatese.

Hyrja kryesore eshte ne pjesen jugore-lindore te shkolles. Kati perdhe te prezanton me hollin kryesor te shkolles. Ne kete holl lexohen dukshem shkallet te cilat jane konceptuar si element i cili i jep identitet shkolles pervec atij funksional, te pozicionuara ne menyre te tille qe levishmeria vertikale dhe ajo horizontale te jete me dinamike.

Holli kryesor i shkolles ka lartësi 7.48 m. Lartësia e katit përdhe është 3.74 m.


Kati perdhe



Plani I katit perdhe

5.2.1.1 KATI I PARE

Në katin e parë ndodhen funksionet administrative, 10 klasa dhe 2 laboratore. Funksionet janë të pozicionuara përgjatë hollit kryesor te shkolles. Lartësia e katit te pare është 3.74m.




5.2.1.2 KATI I DYTE

Në katin e dyte ndodhen funksionet si laboratoret klasa dhe ambiente administrative. Funksionet janë të pozicionuara përgjatë terraces se gjelberuar e cila krijon nje tjeter ambient rekreativ per shkollen. Lartësia e katit te dyte është 3.74m.

STUDIM – PROJEKTIM
 NDËRTIMI SHKOLLËS 9-VJEÇARE “22 TETORI”, BERAT




Plani I katit te dyte




Prerje te objektit

STUDIM – PROJEKTIM
 NDËRTIMI SHKOLLËS 9-VJEÇARE “22 TETORI”, BERAT




Prerje te objektit




Prerje te objektit

STUDIM – PROJEKTIM
 NDËRTIMI SHKOLLËS 9-VJEÇARE “22 TETORI”, BERAT



Pamje te objektit



Pamje te objektit

STUDIM – PROJEKTIM
NDËRTIMI SHKOLLËS 9-VJEÇARE “22 TETORI”, BERAT

Rendera te objektit



OBJEKTI			
F.L. 01 BASHKËRIA BERAT			
DHEKTORI I PËRZEMTËR STUDIM PROJEKTIM NDËRTIMI SHKOLLËS 9-VJEÇARE “22 TETORI”			
“22 TETORI”-JEC STUDIODI REBIB LAKI PIPIRI			
PËR SHËRBIMIN E KËSHIT SHËRBIMI E KËSHIT SHËRBIMI E KËSHIT SHËRBIMI E KËSHIT			
			
PROJEKTI - 02			
NR. 1	OBJEKTI	NR. 001	1.000.000.000
NR. 2	OBJEKTI	NR. 002	1.000.000.000
NR. 3	OBJEKTI	NR. 003	1.000.000.000
NR. 4	OBJEKTI	NR. 004	1.000.000.000
NR. 5	OBJEKTI	NR. 005	1.000.000.000
NR. 6	OBJEKTI	NR. 006	1.000.000.000
NR. 7	OBJEKTI	NR. 007	1.000.000.000
NR. 8	OBJEKTI	NR. 008	1.000.000.000
NR. 9	OBJEKTI	NR. 009	1.000.000.000
NR. 10	OBJEKTI	NR. 010	1.000.000.000
NR. 11	OBJEKTI	NR. 011	1.000.000.000
NR. 12	OBJEKTI	NR. 012	1.000.000.000
NR. 13	OBJEKTI	NR. 013	1.000.000.000
NR. 14	OBJEKTI	NR. 014	1.000.000.000
NR. 15	OBJEKTI	NR. 015	1.000.000.000
NR. 16	OBJEKTI	NR. 016	1.000.000.000
NR. 17	OBJEKTI	NR. 017	1.000.000.000
NR. 18	OBJEKTI	NR. 018	1.000.000.000
NR. 19	OBJEKTI	NR. 019	1.000.000.000
NR. 20	OBJEKTI	NR. 020	1.000.000.000
DHEKTORI I PËRZEMTËR			
IMAZHJE TE OBJEKTIT			
NR. 001			
NR. 002			
NR. 003			
NR. 004			
NR. 005			
NR. 006			
NR. 007			
NR. 008			
NR. 009			
NR. 010			
NR. 011			
NR. 012			
NR. 013			
NR. 014			
NR. 015			
NR. 016			
NR. 017			
NR. 018			
NR. 019			
NR. 020			
PZ	A	A-116	
NR. 1	OBJEKTI	NR. 001	1.000.000.000




OBJEKTI			
F.L. 01 BASHKËRIA BERAT			
DHEKTORI I PËRZEMTËR STUDIM PROJEKTIM NDËRTIMI SHKOLLËS 9-VJEÇARE “22 TETORI”			
“22 TETORI”-JEC STUDIODI REBIB LAKI PIPIRI			
PËR SHËRBIMIN E KËSHIT SHËRBIMI E KËSHIT SHËRBIMI E KËSHIT SHËRBIMI E KËSHIT			
			
PROJEKTI - 02			
NR. 1	OBJEKTI	NR. 001	1.000.000.000
NR. 2	OBJEKTI	NR. 002	1.000.000.000
NR. 3	OBJEKTI	NR. 003	1.000.000.000
NR. 4	OBJEKTI	NR. 004	1.000.000.000
NR. 5	OBJEKTI	NR. 005	1.000.000.000
NR. 6	OBJEKTI	NR. 006	1.000.000.000
NR. 7	OBJEKTI	NR. 007	1.000.000.000
NR. 8	OBJEKTI	NR. 008	1.000.000.000
NR. 9	OBJEKTI	NR. 009	1.000.000.000
NR. 10	OBJEKTI	NR. 010	1.000.000.000
NR. 11	OBJEKTI	NR. 011	1.000.000.000
NR. 12	OBJEKTI	NR. 012	1.000.000.000
NR. 13	OBJEKTI	NR. 013	1.000.000.000
NR. 14	OBJEKTI	NR. 014	1.000.000.000
NR. 15	OBJEKTI	NR. 015	1.000.000.000
NR. 16	OBJEKTI	NR. 016	1.000.000.000
NR. 17	OBJEKTI	NR. 017	1.000.000.000
NR. 18	OBJEKTI	NR. 018	1.000.000.000
NR. 19	OBJEKTI	NR. 019	1.000.000.000
NR. 20	OBJEKTI	NR. 020	1.000.000.000
DHEKTORI I PËRZEMTËR			
IMAZHJE TE OBJEKTIT			
NR. 001			
NR. 002			
NR. 003			
NR. 004			
NR. 005			
NR. 006			
NR. 007			
NR. 008			
NR. 009			
NR. 010			
NR. 011			
NR. 012			
NR. 013			
NR. 014			
NR. 015			
NR. 016			
NR. 017			
NR. 018			
NR. 019			
NR. 020			
PZ	A	A-117	
NR. 1	OBJEKTI	NR. 001	1.000.000.000

6. PALETA E MATERIALEVE

Materialet që ne propozojmë të përdorim për pjesën e fasadës do të jenë veshje me gurë natyrale lokalë, suva të imet si më poshtë si edhe veshje me panele laminat te cilet do te jene imitacion druri dhe metali:



1-Suva grafiato e imet



2-Shtrim me pllaka betoni




3- Shtrim me pllaka guri



4-Veshje me gure natyral



5-Veshje me panele laminat (dru)




6-Veshje me panele laminat (metal)

Për sa i përket shtrimit të shesheve, ne propozojmë që të përdoren pllaka betoni dhe shtrim me pllaka guri.

7. BIMESIA

Për sa i përket llojeve të bimëve dhe pemëve që do të përdoren, rekomandojmë përdorimin e shkurreve të ulëta, si dhe pemët e larta që do të jenë por pa u kufizuar në :



1-Pisha



2-Bredh

STUDIM – PROJEKTIM
NDËRTIMI SHKOLLËS 9-VJEÇARE “22 TETORI”, BERAT



3-Lisi



4-Ulliri